**LIGJ**
**Nr. 72 /2020**

# PËR EMETIMIN E INSTRUMENTIT "EUROBOND" NGA MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË, MIRATIMIN E PËRJASHTIMEVE NGA TATIMET E TAKSAT DHE HEQJEN DORË NGA IMUNITETI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë, lidh marrëveshje për emetimin e instrumentit "Eurobond", thelbësisht sipas kushteve të përcaktuara në tekstin e tyre që i bashkëlidhet këtij ligji.
2. Emetuesi, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar nga ndonjë mosmarrëveshje, heq dorë nga imuniteti, sipas përcaktimeve në aktet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 2

Mbajtësit e titujve të eurobondit dhe menaxherët bashkëdrejtues, sipas marrëveshjeve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 1 të këtij ligji, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe nga çdo tatim apo taksë tjetër në Republikën e Shqipërisë, për të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen dhe tregtimin e eurobondeve.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

Miratuar në datën 4.6.2020

**Shpallur me dekretin nr. 11503, datë 5.6.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**